




Periodik mujor Nr. 195 Gusht 2025

Në këtë
periodik
do të lexoni:

Publikohet
“Gjeografia e Sigurimeve 2024”



VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri,
Janar - Qershor 2025

3

ZHVILLIME TË TJERA

4-5

BOTIME PROFESIONALE

6-8

INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

9-12

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar – Korrik, 2025

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për janar – korrik 2025 kapën vlerën 15,473 milionë lekë, ose 8.98% më shumë se në janar – korrik 2024. Gjatë periudhës janar – korrik 2025, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 929,459 me një rritje prej 6.81% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.34% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.63% dhe risigurimi me 0.03%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.75% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.25% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar – korrik 2025, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 4,804 milionë lekë, ose 0.90% më shumë se në janar – korrik 2024.


Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për janar – korrik 2025 kapën vlerën 3,685 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 7.87% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar-korrik 2025 arritën rreth 9,322 milionë lekë, ose 13.13% më shumë se në janar – korrik 2024.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar – Korrik 2025 (Në %)



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare publikon Gjeografinë e Sigurimeve 2024



Gjeografia e Sigurimeve 2024, pasqyron në mënyrë të detajuar shpërndarjen e primeve të shkruara bruto, dëmeve të paguara si edhe primit për frymë, sipas prefekturave.

Duke analizuar shpërndarjen gjeografike të primit të shkruar bruto, vërehet një përqendrim i tregut të sigurimeve në prefekturat e mëdha, si Tirana me 62.09% të totalit të primeve të shkruara bruto gjatë vitit 2024, Durrësi me 7.18%, Korça 5.15%, Vlora 4.60% dhe Fieri 4.53%.

Një tregues tjetër i rëndësishëm i tregut të sigurimeve është dendësia e sigurimeve. Për vitin 2024 ky tregues është rreth 10,364.79 lekë për frymë, me një rritje rreth 838.63 lekë krahasuar me një vit më parë.

Përsa i përket primit për frymë sipas prefekturave, prefektura Tiranë me 20,011.64 lekë për frymë zë vendin e parë, e pasuar nga prefektura Durrësi me 7,885.51 lekë për frymë, Vlora me 7,819.41 lekë për frymë dhe më tej Gjirokastrë me 7,697.89 lekë për frymë dhe Korçë me 7,506.08.

Ky publikim përfshin gjithashtu edhe informacion të hollësishëm për dëmet e paguara gjatë vitit 2024 sipas prefekturave, duke krijuar edhe mundësinë e krahasimit të këtyre treguesve me ato të një viti më parë. Përsëri pjesën më të madhe të dëmeve të paguara e ka prefektura e Tiranës me 67.94%, e pasuar nga prefektura Durrësi me 10.10%

**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare:
Paralajmërim për platformat mashtruese TXEX, XUEXA,
GROKREXDUU dhe platforma të ngjashme**



Informacion më i plotë
gjendet në faqen online
të AMF-së

<https://amf.gov.al/news.asp?id=73313#>

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në ushtrim të kompetencave të tij ligjore për mbrojtjen e interesave të investitorëve dhe ruajtjen e integritetit të tregjeve nën mbikëqyrje, informon publikun mbi veprimtarinë e paligjshme të platformës TXEX, si dhe të platformave të ngjashme XUEXA dhe GROKREXDUU. Këto subjekte nuk janë të licencuara apo të autorizuara nga AMF për të ofruar shërbime investimi në Republikën e Shqipërisë.


Nga informacionet e siguruar rezulton se këto platforma paraqiten si aplikacione investimi që u ofrojnë përdoruesve të ashtuquajtura “sinjale blerjeje” për krypto-asete, duke krijuar përshtypjen tek investitorët se mund të ndikojnë mbi çmimet dhe të realizojnë përfitime. Ky mekanizëm në tërësinë e tij është fiktiv dhe nuk pasqyron veprime reale të kryera. Kjo veprimtari bie ndesh me legjislacionin në fuqi dhe përbën vepër mashtruese që cënon drejtpërdrejt interesat e investitorëve shqiptarë.

AMF, deri më sot, nuk ka licencuar apo autorizuar asnjë subjekt për të operuar në këto tregje në përputhje me Ligjin nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”.

Lista e subjekteve të licencuara nga Autoriteti ndodhet në rubrikën “Regjistri i të Licencuarve” në faqen zyrtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

OECD PUBLIKON RAPORTIN: “PËRSHKALLËZIMI I FINANCIMEVE DHE INVESTIMEVE PËR PËRSHTATJEN NDAJ KLIMËS

**Dokumenti prezantues për Grupin e Punës të Financave
të Qëndrueshme, të G20**



Informacioni gjendet në:

https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2025/07/scaling-finance-and-investment-for-climate-adaptation_be6892fb/eeec8b52-en.pdf

Abstrakt:

Temperaturat mesatare globale tejkalojnë pragun prej 1.5°C mbi nivelet para-industriale në vitin 2024, dhe humbjet ekonomike nga ngjarjet ekstreme të lidhura me motin po rriten me shpejtësi, me pasoja të thella sociale dhe ekonomike. Përshpejtimi i investimeve në përshtatje të këtyre zhvillimeve klimatike është një element kritik i përpjekjeve më të gjera e të nevojshme për të rritur qëndrueshmërinë.

vijon ...

OECD PUBLIKON RAPORTIN: “PËRSHKALLËZIMI I FINANCIMEVE DHE INVESTIMEVE PËR PËRSHTATJEN NDAJ KLIMËS

... vijon

Ky raport, i hartuar nga OECD në bashkëpunim me Bankën Afrikane të Zhvillimit, identifikon barrierat kryesore të ndërlidhura që pengojnë investimet, duke përfshirë sfidat makroekonomike dhe ato të lidhura me kapacitetin, barrierat specifike për investimet publike dhe private, dhe aksesin në financimin ndërkombëtar e koncesionar. Adresimi i përshtatjeve që duhen bërë përballë hendekut të investimeve do të kërkojë përpjekje të shtuara për të mobilizuar dhe përafuar flukset e financimit nga të gjitha burimet për të mbështetur zhvillimin rezistent ndaj klimës. Për ta arritur këtë, raporti propozon veprime strategjike në të gjithë kapacitetin dhe të dhënat, politikat vendase dhe mbështetjen ndërkombëtare. Këto përfshijnë forcimin e aksesit në të dhënat klimatike, përmirësimin e transparencës, integrimin e përshtatjes në planifikimin dhe buxhetimin kombëtar, rritjen e kontributit të tregjeve të sigurimeve, shfrytëzimin e financave të përziera dhe produkteve financiare inovative, dhe përmirësimin e koordinimit. Një analizë e thellë e dedikuar mbi Afrikën nxjerr në pah cenueshmërinë joproporcionale të kontinentit dhe përshkruan mundësitë për të mbështetur investimet në përshtatje përmes qasjeve të përshtatura.

Informacioni
gjendet në:

https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2025/07/scaling-finance-and-investment-for-climate-adaptation_be6892fb/eeec8b52-en.pdf



RAPORTI BOTËROR I “MUNICH RE” PËR FATKEQËSITË NATYRORE

Sipas shifrave të publikuara nga “Munich Re” për fatkeqësitë natyrore, në gjysmën e parë të vitit 2025 u shkaktuan humbje të përgjithshme prej rreth 131 miliardë USD, nga të cilat 80 miliardë USD ishin të siguruara. Sipas raportit, katastrofat natyrore në SHBA dominojnë humbjet globale në gjysmën e parë të vitit 2025.

Si humbjet e përgjithshme ashtu edhe humbjet e siguruara ishin dukshëm më të larta se mesatarja për 30 vitet e mëparshme. Humbjet e siguruara në gjysmën e parë të vitit 2025 ishin të dytat më të larta (për gjysmën e parë të çdo viti) që nga fillimi i regjistrimeve në vitin 1980. Vetëm në gjysmën e parë të vitit 2011 humbjet e siguruara ishin edhe më të larta, për shkak të një tërmeti të fortë dhe cunami shkatërrues në Japoni.

Fatkeqësitë atmosferike shkaktuan 88% të humbjeve të përgjithshme dhe 98% të humbjeve të siguruara, ndërsa tërmetet përbënin pjesën tjetër, përkatësisht 12% dhe 2%.

Raporti nxjerr disa përfundimet kryesore:

- Humbje të larta të përgjithshme prej rreth 131 miliardë USD, ishin shumë mbi mesataren afatgjatë;
- Zjarret në periferi të Los Anxhelosit në janar shkaktuan humbjet më të larta nga zjarret në pyje të të gjitha kohërave;
- Shpenzime shumë të larta për kërkesa për siguruesit: Pothuajse 80 miliardë USD, kryesisht të shkaktuara nga zjarret në SHBA;
- Humbjet e siguruara ishin të dytat më të larta në gjysmën e parë të çdo viti, që prej vitit 1980.

Thomas Blunck, Anëtar i Bordit të Menaxhimit të “Munich Re” komentoi raportin se “Ndryshimi i klimës është një fakt që po ndryshon jetën në tokë. Fatkeqësitë si ajo në Los Anxhelos ndodhin për shkak të ngrohjes globale dhe na japin një mësim shumë të rëndësishëm: njerëzit, autoritetet dhe kompanitë duhet të përshtaten të gjithë me rrethanat e reja. Mënyra më e mirë për të shmangur humbjet është të zbatohen masa efektive parandaluese, të tilla si ndërtime më të forta për ndërtesat dhe infrastrukturën për t'i bërë ballë më mirë fatkeqësive natyrore. Masa të tilla paraprake mund të ndihmojnë në ruajtjen e primeve të arsyeshme të sigurimit, madje edhe në zonat me rrezik të lartë. Dhe më e rëndësishmja: për të zvogëluar ekspozimin në të ardhmen, zhvillimi i ndërtesave të reja nuk duhet të lejohet në zonat me rrezikshmëri të lartë”.

Informacioni
gjendet në:

<https://www.munichre.com/en/company/media-relations/media-information-and-corporate-news/media-information/2025/natural-disaster-figures-first-half-2025.html>

INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

BULLGARI

www.xprimm.com

Sekretarja e Përgjithshme e Shoqatës së Siguruesve Bullgarë (ABZ) Nina Kolchakova u shpreh për Xprimm se pavarësisht numrit në rritje të zjarreve dhe fatkeqësive natyrore, sigurimi i shtëpive në Bullgari mbetet jashtëzakonisht i ulët, me rreth 10% e pronës së siguruar. Kjo shifër tregon që Bullgaria mbetet në vendin e fundit në Evropë për sigurimin e pronës. Sipas saj, arsyeja është kryesisht mungesa e ndërgjegjësimit për nevojën e këtij sigurimi. Megjithatë, po vihet re tendenca në rritje e sigurimeve për këtë kategori prone, ndonëse me ritëm shumë të ngadaltë. Nga pikëpamja e shpërndarjes gjeografike, vërehet se ka dallime të konsiderueshme në sigurimin e pronave sipas vendndodhjes. Shtëpitë në qytete janë kryesisht të siguruar, të nxitura më së shumti nga nevoja e marrjes së kredive dhe hipotekave. Në qytetet e vogla dhe në fshatra, pjesa e pronave të siguruar është e papërfillshme.

"Pothuajse 90% e bullgarëve jetojnë në shtëpitë e tyre dhe megjithatë nuk i sigurojnë ato, dhe në shumicën e rasteve kjo është pasuria e tyre më e vlefshme. Paradoksisht, janë më shumë makina të siguruar sesa shtëpi. Të paktën 30% e makinave kanë sigurim gjithëpërfshirës motorik", theksoi Nina Kolchakova. Arsyeja kryesore pse njerëzit shmangin sigurimin është frika se në rast dëmtimi nuk do të marrin kompensim, megjithatë, sipas statistikave, rreth 95% e dëmeve paguhen.

Lidhur me sigurimin bujqësor, Nina Kolchakova theksoi se gjithnjë e më shumë fermerë po blejnë sigurim. Shqetësimet e tyre lidhen me faktin se siguruesit nuk ofrojnë mbulim për disa rreziqe, siç janë ngricat e hershme të pranverës para 20 prillit. Sekretarja e Përgjithshme e Shoqatës shpjegoi se po diskutohet me Ministrinë e Bujqësisë në vend mbi mundësi të ndryshme për të adresuar problemin me ngricat e hershme dhe thatësinë.

KOSOVË

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të ofruara nga Banka Qendrore, tregu i sigurimeve në vend, në fund të tremujorit të parë 2025, arriti një vlerë totale të primeve të shkruara bruto prej 40.46 milionë euro. Kjo shifër shpreh një rritje prej 5% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Nga vlera totale e primeve të shkruara bruto, rreth 50% ose 20.18 milionë euro lidheshin me sigurimin e detyrueshëm motorik: 18.76 milionë euro për MTPL-në vendase dhe 1.4 milionë euro për policat kufitare.

Dëmet e paguara arritën vlerën e 21.66 milionë euro, me një rritje 23.77% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ku sigurimi i detyrueshëm MTPL-së realizoi rreth gjysmën e kësaj shume.

POLONI

www.xprimm.com

Sipas Shoqatës Polake të Sigurimeve (PIU) vëllimi i primeve të shkruara bruto i siguruesve polakë, në tremujorin e parë të vitit 2025, arriti në 5.36 miliardë euro (rreth 22.43 miliardë PLN). Kjo shifër, e shprehur në monedhën evropiane është 5% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Dëmet e paguara arritën në 3.21 miliardë euro (rreth 13.46 miliardë PLN), që shpreh një rritje prej 15.65% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Sipas Shoqatës Polake të Sigurimeve numri i polakëve të siguruar është duke u rritur vazhdimisht. "Vit pas viti, po paguajmë më shumë për dëme si në sigurimin e Jetës ashtu edhe në atë të pronës. Në fund të tremujorit të parë të vitit 2025, sektori pagoi mbi 12% më shumë sesa gjatë së njëjtës periudhë të një viti më parë, duke përfshirë pothuajse 16% më shumë në sigurimin e pronës. Shpresoj që këtë vit do të jemi në gjendje të ruajmë dinamikën relativisht të lartë të rritjes së tregut, veçanërisht në segmentin e pronës, të ngjashme me vitin 2024", u shpreh Piotr Wrzesiński, Zëvendës president i Bordit Drejtues të Shoqatës Polake të Sigurimeve.

Sigurimi i Jetës

Sipas PIU-së, 25.1 milionë kontrata sigurimi Jete u lidhën në tremujorin e parë të vitit 2025, duke përfshirë 11.1 milionë polica individuale dhe 14 milionë polica sigurimi në grup. Vëllim i primeve të shkruara bruto nga sigurimi i Jetës arriti në 1.4 miliardë euro (rreth 5.9 miliardë PLN). Kjo përfaqëson një rritje prej 0.6% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi motorik

Sigurimi motorik përbën pjesën më të madhe në vëllimin e primeve të shkruara bruto dhe po ashtu edhe të dëmeve të paguara. Ndërsa vëllimi i primeve arriti në 1.12 miliardë euro (rreth 4.7 miliardë PLN) për sigurimin e detyrueshëm MTPL, dëmet e paguara arritën në rreth 749 milionë euro (3.1 miliardë PLN) në tremujorin e parë të vitit 2025. Këto shifra përfaqësojnë një rritje prej 6.3% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë, pavarësisht rritjes së kostove, primi mesatar i sigurimit MTPL u rrit vetëm me 5.4%, duke arritur në 555 PLN. Në fund të tremujorit të parë 2025, dëmi mesatar i sigurimit MTPL u rrit me 9.9% krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 10,942 PLN.

Sipas PIU, vëllimi i primeve të shkruara bruto për linjat e sigurimit të pronës arriti në 806 milionë euro (3.37 miliardë PLN), duke shënuar një rritje 3.7% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Dëmet e paguara për fatkeqësi natyrore dhe dëme të tjera të pronës arritën në 320 milionë euro (1.3 miliardë PLN), që është pothuajse 47% më shumë se një vit më parë.

MAQEDONI E VERIUT

www.xprimm.com

Në tremujorin e parë të vitit 2025, siguruesit në Maqedoninë e Veriut realizuan një volum të primeve të shkruara bruto me vlerë 79.7 milionë euro. Kjo vlerë është 18.07% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke ruajtur ritmin e vendosur në tremujorin e parë të vitit 2024. Dëmet e paguara u rritën me rreth 10%, duke arritur në 25.8 milionë euro.

Strukturat e tregut mbetën pothuajse të pandryshuara, të dominuar nga sigurimi i Jo-Jetës. Ndryshimet të dukshme u regjistruan për sigurimin nga zjarri dhe klasat e sigurimit të detyrueshëm MTPL, të cilat pësuan një rritje të ndjeshme në totalin e tregut.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 4.5%, duke arritur në 12.2 milionë euro. Në klasat e sigurimit të pronës u vërej rritje dhe sidomos sigurimi nga zjarri pati rritje duke arritur në 10.38 milionë euro, pothuajse dyfishin e vlerës së primeve të realizuara në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Duket se mësimet e nxjerra nga ngjarjet ekstreme të motit kanë rritur ndërgjegjësimin për rreziqet klimatike. Megjithatë, ende ekziston një boshllëk i madh në mbrojtjejen ndaj tyre.

QIPRO

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Shoqatës së Sigurimeve të Qipros, (IAC) tregu i sigurimeve në vend, në fund të tremujorit të parë 2025, arriti në 346.5 milionë euro, duke u rritur me 5% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Dëmet e paguara bruto u rritën me 7% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 153.27 milionë euro. Pjesën më të madhe të dëmeve të paguara e zinin ato për sigurimin e Jetës, me vlerë rreth 89.8 milionë euro, me një rritje mbi 24.86% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërsa dëmet e paguara për sigurimin e Jo-Jetës arritën në vlerën e 63.5 milionë euro, duke shënuar ulje me rreth 11%.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto për sigurimet e Jo-Jetës arriti në 168.24 milionë euro, me një rritje me 6.8% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndërsa sigurimet e Jetës realizuan prime me vlerë rreth prej 178.25 milionë euro, ose 3.3% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

RUMANI

www.xprimm.com

Sipas raportit të publikuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, (ASF) të Rumanisë, vëllimi i primeve të shkruara bruto të realizuar në tremujorin e parë të vitit 2025 nga siguruesit vendas dhe degët e siguruesve të huaj që operojnë në FOE arriti në total 1.19 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej 7.24% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nga kjo vlerë e primeve, 14 degët e siguruesve të huaj që operojnë në Rumani realizuan rreth 12.5% të totalit.

Në totalin e primit të shkruar bruto, sigurimi i Jo-Jetës zinte peshën më të madhe, me 79% në portofolin e tregut, me vlerë 940.3 milionë euro. Ndërsa sigurimi i Jetës përbën rreth 21% ose 255 milionë euro. Sigurimi i detyrueshëm motorik, MTPL është linja e sigurimeve për të cilën kontributi i degëve të huaja është më i fortë. Ky sigurim realizoi një vëllim primesh prej 460.3 milionë euro dhe rreth 18.6% u realizua nga aktiviteti i degëve të huaja.

Në fund të tremujorit të parë, tregu i sigurimeve në vend përfshinte 25 kompani sigurimi të autorizuar nga ASF Romania dhe 14 degë të huaja.

SERBI

www.xprimm.com

Sipas statistikave të fundit të tremujorit të parë 2025, të publikuara nga Banka Kombëtare e Serbisë, siguruesit në vend e mbyllën tremujorin e parë të vitit 2025 me një total të primeve të shkruara bruto prej 45 miliardë dinarë ose rreth 384 milionë euro. Kjo shifër tregon një rritje prej rreth 8% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Tregu dominohet nga sigurimi Jo-Jetës, i cili gjeneroi 82.9% të të gjitha primeve. Klasat më të mëdha në sigurimet e Jo-Jetës ishin MTPL, dëmet ndaj pronës, sigurimi shëndetësor, sigurimi Kasko. Të gjitha regjistruan rritje pozitive në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimi i Jetës pati një rritje vjetore prej 4.2% dhe pjesa e tij në portofolin e tregut ra në 17.10%.

Totali i dëmeve të paguara u rrit me 10.85% duke arritur në 20.8 miliardë dinarë, ose rreth 178.14 milionë euro, i nxitur më shumë nga rritjet e raportuara në pothuajse të gjitha nënklasat e sigurimeve të Jo-Jetës. Dëmet e paguara në sigurimin motorik u rritën me pothuajse 7% (11% për MTPL), ndërsa në sigurimin e pronës (sigurimi nga zjarri) kompanitë paguan 22.4% më shumë dëme se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Për informacion
të mëtejshëm
kontakttoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al